



Reconstruction Implementation Commission
for Orthodox Religious Sites in Kosovo

DEKLARATE PER SHTYP 21 Dhjetor 2005

FAZA E PARE E PROCESIT TE RINDERITIMIT ESHTË PERFUNDUAR ME SUKSES

Komisioni për Implementimin e Rindërtimit (KIR) shpall përfundimin e punëve mbrojtëse dhe konsoliduese në 30 tërësi kulturore Ortodokse të dëmtuara gjatë trazirave të marsit 2004. KIR-ja konsideron se qëllimet, për mbrojtjen e tërësive nga dëmtimi i mëtejme para dimrit është arritur.

KIR-ja ka filluar me punë në qershor 2005 si rezultat i marrëveshjes në mes të KOS dhe IPVQ për t'i riparuar kishat e dëmtuara në Mars të vitit 2004. IPVQ ka financuar të gjitha intervenimet pos në Kishen e Shën Nikollës në Prizren, e cila është ndihmuar nga ana e donacionit të zyrës së SHBA-ve.

Në mes të qershorit dhe shtatorit të vitit 2005, KIR ka përgatitur tenderët për intervenime emergjente për 30 tërësi, ku implementimi i tyre ka filluar nga Tetori 2005. Punët më intensive të rindërtimit dhe preservimit do të vazhdojnë gjatë 2006. Si pjesë e programit afat gjatë të konservimit, KIR ka organizuar një mision të ekspertëve për të studiuar pikturat murale përbrenda tërësive të dëmtuara.

KIR udhëhiqet nga ekspertja ndërkombëtare Znj. Emma Carmichael, e emëruar nga Këshilli i Evropës (KE) dhe përfshinë përfaqësuesit e MKRS, KOS dhe nga Insituti i Mbrojtjes së Monumenteve të Kosovës dhe Beogradit.

Partnerët ndërkombëtarë, KE, UNMIK dhe Komisioni Europian, kanë shfaqur kënaqsinë jo vetëm për punët konkrete të KIRit, por edhe me bashkëpunimin e treguar mes IPVQ, KOS, Institucioni nga Serbia si dhe nga profesionistët që e kanë bërë këtë punë të mundshme. KIR ka dëshmuar të jetë një mekanizëm i bashkëpunimit mes shoqërive aksionare të ndryshme në fushën e trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe të gjithë partnerët lokal dhe ndërkombëtarë janë zotuar në vazhdimin e punëve në 2006.



CoE Secretariat Office in Kosovo, UNHCR HQ Building, 6th Floor, Kragujevci 8, 10000 Pristina, Kosovo
Tel : +381 (0) 38 243- 749 / 750 / 751 - Fax : +381 (0) 38 243 752

RIC Secretariat, Ministry of Culture, Youth and Sports, Room 132, Mother Theresa No. 35, Pristina, 10000, Kosovo
Tel: +381 (0)38 20022- 054 / 059/ 073 - Fax: +381 (0)38 200 220 62



Reconstruction Implementation Commission
for Orthodox Religious Sites in Kosovo

PERMBLEDHJA E INTERVENIMEVE TE KRYERA GJATE 2005

- Rrethojat mbrojtëse të vendosura në Kishat e Shen Premtes ne Shipasnice e Poshtme, Shfaqja e Shen Merise dhe Shën Florit e Laurit në Lipjan.
- Masat mbrojtëse në konsolidimin e mbetjeve në kishat e Shen Ilise në Bistazhin, Shën Merisë në Gjakove dhe në kapellën e varrezave të shën Llazarit në Piskote, ku një numër I madh I varrezave janë riparuar poashtu.
- Masat e mëtejme mbrojtëse, duke përfshirë edhe mbulojat e përkoshme, janë bërë në Kishën e Shën Nikolles në Pristhine, katedrala e Shën Gjergjit në Prizren dhe Shen Ilise ne Vushtri. Intervenimet e mëtejme në keto kisha janë në programin e 2006.
- Riparime të vogla në kishen e Shen Premtes në Viti, Shen Mëhillit ne Obiliq, Shen Nikolles ne F Kosove, Mbret Uroshit ne Ferizaj dhe Shen Mëhillit ne Shtime kane përfunduar.
- Punë të medha stabilizuese dhe konsoliduese janë kryer ne Kishen e Shen Merise Ljeviska, Shen Nikolles (Tutiqit), Shen Gjergjit (Runoviqit), Shen Shpetimit dhe Shen Djelles se shenjtë ne Prizren, , Shen. Joanikije ne Deviq, Shfaqja e Shen Merise në Bellopolje, Shen. Sava në Mitrovicë dhe Shen. Ndreut në Podujevë. Riparime të brendshme dhe të jashtme do të vazhdojnë gjatë vitit të ardhshem.
- Kishat dhe varrezat janë riparuar në tërësite e Shen Pjetrit dhe Palit në Talinoc, Shen. Ilias në Varoshe dhe varrezat e Serbëve në Ferizaj dhe Kapella në Ferizaj.
- Përfundimi I punëve rindërtuese në kishat e Lindjes së Shen Merise në Softe, Shen. Pjeter dhe Palit në Istog, Shen. Gjon Pagezuesit në Peje dhe mensën e kishes së Shen.Djelles se shenjte në Brnjake.



CoE Secretariat Office in Kosovo, UNHCR HQ Building, 6th Floor, Kragujevci 8, 10000 Pristina, Kosovo
Tel : +381 (0) 38 243- 749 / 750 / 751 - Fax : +381 (0) 38 243 752

RIC Secretariat, Ministry of Culture, Youth and Sports, Room 132, Mother Theresa No. 35, Pristina, 10000, Kosovo
Tel: +381 (0)38 20022- 054 / 059/ 073 - Fax: +381 (0)38 200 220 62